



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Korrigjuar i

Urdhrit për Caktimin e Datës së Konferencës për Ecurinë e Çështjes

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit kujdestar të të

Akuzuarit

Julius von Bone

Zyrës Administrative

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe

Mbështetjen e Dëshmitarëve

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji²) dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës (“Vendimi i Konfirmimit”),² Fletarrestimin për z. Salih Mustafa³ dhe Urdhrin për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara.⁴
2. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.⁵
3. Më 24 shtator 2020, Salih Mustafa (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”) u arrestua⁶ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁷

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publik).

⁶ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, *Njoftim për Pranim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 28 shtator 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Urdhrin për Parashtrime lidhur me Sistemin e Redaktimit.⁸

5. Më të njëjtën ditë, u mbajt paraqitja e parë e z. Mustafa.⁹ Gjatë seancës i akuzuari deklaroi se kupton dhe flet shqip.¹⁰ Gjithashtu, Mbrojtja shprehu preferencën që ta mbajë konferencën në fillim të javës 5-9 tetor 2020.¹¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thërret konferencën për ecurinë e çështjes sa më parë që është e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, midis të tjerash: (i) për të organizuar shkëmbime midis palëve dhe, sipas rastit, me Mbrojtësin e Viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; dhe (ii) për të ndërmarrë hapa për t'u siguruar se po bëhen të gjitha përgatitjet e nevojshme nga palët me kohë dhe në mënyrë të zellshme.

7. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante në zotërim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj, dhe i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kompensuese. Në bazë të rregullës 102(3), ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

8. Në bazë të rregullës 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 105, 106, 107, dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, sipas rastit, Mbrojtësit të Viktimave, sa më parë që është e mundshme dhe së paku brenda 30

⁸ KSC-BC-2020-05, F00022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime lidhur me Sistemin e Redaktimit*, 28 shtator 2020, publik.

⁹ KSC-BC-2020-05, T. 28 shtator 2020, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-05, T. 28 shtator 2020, publik, f. 4, rreshti 14.

¹¹ KSC-BC-2020-05, T. 28 shtator 2020, publik, f. 17, rreshtat 5-7.

ditësh nga paraqitja e parë, materialin mbështetës të Aktakuzës së Konfirmuar si dhe çdo deklaratë të marrë nga i akuzuari.

9. Në bazë të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialin në vijim: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në gjuhën që i akuzuari e kupton dhe e flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet apo transkriptet që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

10. Në bazë të rregullës 102(2) dhe (4) të Rregullores, deklarata të dëshmitarëve shtesë, të cilat nuk i janë bërë të njohura Mbrojtjes deri në afatin prej 30 ditësh nga hapja e çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim, i vihen në dispozicion Mbrojtjes, në gjuhën që i akuzuari e kupton dhe e flet, sa më parë që është e mundshme së bashku me arsyen për nxjerrjen e vonuar të materialeve. Kjo nxjerrje duhet të përfundohet gjatë fazës paraprake.

11. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja nxjerr për Mbrojtjen, me kërkesë të saj dhe pa vonesë, çdo deklaratë, dokument dhe fotografi dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë apo i përkisnin të akuzuarit.

12. Në bazë të rregullës 103 të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion, sapo të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë në provat e ZPS-së.

13. Në bazë të nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80(1) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të urdhërojë masa mbrojtëse të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë,

mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari.

14. Në bazë të rregullës 80(4)(a)(i)-(iii) dhe (d) të Rregullores, këto masa mund të përfshijnë redaktimin e emrave dhe informacionin identifikues për të parandaluar nxjerrjen për të akuzuarin dhe/ose për publikun, kur është e domosdoshme, të identitetit dhe ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces gjyqësor ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me ta.

15. Në bazë të rregullës 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë Trupit Gjykues për mosnxjerrjen e informacionit në tërësi ose pjesërisht kur nxjerrja e këtij informacioni mund, midis të tjerash, të cenojë hetimet aktuale ose hetimet e ardhshme. E njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

16. Në bazë të rregullës 107(2) të Rregullores, ZPS-ja i dorëzon trupit gjykues kërkesë për t'u liruar tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi sipas rregullave 102 dhe 103 të Rregullores për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin e ka në zotërim ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllime të gjetjes së provave të reja dhe për nxjerrjen e të cilit nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit.

III. DISKUTIM

17. Pas paraqitjes së parë të z. Mustafa, procesi i nxjerrjes së provave dhe materialit nga ZPS-ja për Mbrojtjen pritet të fillojë së shpejti, në pajtim me kornizën ligjore të lartpërmendur dhe në mënyrën dhe afatet që do të përcaktohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Për këtë, siç është përcaktuar në rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thërret konferencën për ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes për të marrë parashtrime në lidhje me pikat e rendit të ditës në shtojcën e këtij urdhri dhe në lidhje me çdo temë përkatëse që nuk është mbuluar

në listën e bashkëngjitur të materialeve, që palët e vlerësojnë të nevojshme. Gjithashtu, përfaqësuesit e Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") ftohen të marrin pjesë në konferencën për ecurinë e çështjes, duke pasur parasysh rolin e ZMMD-së në ofrimin e mbrojtjes për dëshmitarë, në përputhje me nenet 23(1) dhe 34(8) të Ligjit.

18. Gjithashtu, ftohen palët që të bëjnë parashtrime me shkrim për çdo pikë të renditë ditës në shtojcën e këtij urdhri apo për tema të tjera që i gjykojnë të nevojshme, nëse dëshirojnë. Kur informacioni nuk mund të shkëmbehet me asnjë palë për arsye të konfidencialitetit dhe mbrojtjes, parashtrimet mund të bëhen me shkrim *ex parte* ose në seanca private/të mbyllura vetëm në prani të palës së interesuar. Informacioni i dhënë nga palët, me gojë ose me shkrim, do ta ndihmojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake gjatë formulimit të vendimit kornizë mbi nxjerrjen e materialit dhe afateve përkatëse.

19. Kujtojmë se, megjithëse z. Mustafa dhe Mbrojtja e tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm personalisht, në përputhje me rregullën 96(2) të Rregullores, duke pasur parasysh natyrën teknike të temave që do të diskutohen, në konferencën për ecurinë e çështjes: (i) mund të jetë i pranishëm i akuzuari me pjesëmarrjen e Mbrojtjes përmes videokonferencës; (ii) mund të jetë e pranishme Mbrojtja, me pjesëmarrjen e të akuzuarit përmes videokonferencës; ose (iii) i akuzuari mund të mungojë, me Mbrojtjen e pranishme ose me pjesëmarrjen e saj përmes videokonferencës. Gjithsesi për këto masa është i nevojshëm pëlqimi me shkrim i të akuzuarit, pasi të jetë këshilluar me mbrojtësin në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores.

20. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton ZPS-në të bëjë parashtrime rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, nëse do të ketë, në lidhje me redaktimet e propozuara që do t'i zbatojë Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit, për t'ia vënë në dispozicion Mbrojtjes dhe publikut.

Shpjegim

Në ballinë është hequr emri i një punonjësi të DHSK-së.